

Protokolli për veprim gjatë akomodimit të nxënësve në konviktet publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin shkollor 2021/2022

1. Dita e parë duhet të fillojë me udhëzime për të gjithë nxënësit , se si të sillen në mënyrë të duhur dhe të sigurt, të mbajnë maska, të mbajnë distancën fizike, higjenën e duarve dhe mbrojtjen e shëndetit të tyre, por edhe shëndetin e nxënësve dhe stafit të tjerë në shtëpi.
2. Konvikti i nxënësve për hyrje dhe dalje i vë në funksion të gjitha hyrjet në konvikt për nxënës
3. Dezinfektuesi i duarve duhet të vendoset në hyrje të secilit konvikt.
4. Për të kontrolluar hyrjen dhe daljen në /nga konvikti, para dhe brenda organizohet shërbim -roje, për të zbatuar urdhrin, dezinfektim të detyrueshëm dhe vendosja e maskave mbrojtëse, duke ruajtur distancën e nevojshme midis nxënësve
5. Në hyrje të konviktit të vendosni materiale edukative-informative për respektimin e masave parandaluese mbrojtëse: mbajtja e maskave mbrojtëse, mbajtja e distancës fizike, dezinfektimi i rregullt i duarve dhe higjiena e duhur e respiratorëve .
6. Të gjithë nxënësit dhe punonjësit gjatë lëvizijes në konvikt dhe hapsira të përbashkëta në konvikt (aktivitete , në salla të klubeve, korridore, në kuzhinë ...) duhet të mbajnë maskë mbrojtëse.
7. Ajrosje e përditëshme e hapsirave dhe dhomave të përbashkëta në konvikt .
8. Dy herë në ditë, është e detyrueshme pastrimi dhe dezinfektimi i hapsirave të përbashkëta të konviktit (korridoret, biblioteka, salla e leximit, mensa, etj.) Me dezinfektues që vepron mbi viruset, sipas udhëzimeve të prodhuesit, mund të përdoret në mënyrë alternative 0.05 hipoklorit natriumi (5% zbardhues shtëpiak e përdorur në përzierje 1: 100) ose 70% alkool për dezinfektimin e sipërfaqeve të sipërme. Stafi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë pastrimit dhe dezinfektimit të sendeve që preken nga numëri i madh i duarve (p.sh. parmakët e shkallëve, çelsat, dorezat, rubinetat në lavamanë, etj.) Dhomat e akomodimit duhet të pastrohen dhe ventilohe rregullisht.
9. Të gjithë nxënësit duhet të kujdesen për mbajtjen e higjienës dhe dezinfektimit në dhomat ku ata qëndrojnë. Për këtë qëllim, konviktet u sigurojnë atyre sasi të mjaftueshme të artikujve të higjienës dhe pajisjeve për ruajtjen e higjienës.
10. Nxënësi gjatë vendosjes në konvikt , merr çelës nga dhoma, ai gjithashtu merr një fletushkë me këshilla mbrojtëse dhe protokoll për qëndrimin e tij në konvikt .
11. Në dhomë preferohet të vendosen nxënës nga e njëjta paralele ose e njëjta shkollë.

12. Nxënësve nuk duhet t'u lejohen ndërrimi i dhomave.
13. Nxënësit që do të jenë të pranishëm në sallën e leximit duhet të mbajnë maska mbrojtëse. Gjatë mësimit , ulja kryq duhet të preferohet duke i kushtuar vëmendje distancës fizike.
14. Mbani distancë në bibliotekë gjatë marrjes së librave.
15. Edukatorët përgatisin orar për shfrytëzimin e veprimtarive në konvikt dhe hapsirave ku zhvillohen aktivitetet e lira të nxënësve me respektimin e të gjitha masave mbrojtëse.
16. Në konviktet për nxënësit me nevoja të veçanta, gjatë aktiviteteve të pasdites, gjatë përgatitjes së nxënësve për mësim, do të përdoren metoda dhe teknika vizuele dhe përdorimi i gjuhës së shenjave të përshtatshme për aftësitë dhe nevojat e secilit nxënës, duke zbatuar të gjitha masat mbrojtëse.
17. Edukatorët mbajnë komunikim të rregullt me prindërit për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të nxënësve, si dhe për suksesin dhe sjelljen e përgjithshme në shkollë me telefon, e-mail ose një takim të përbashkët ZOOM me prindërit e nxënësve në grup arsimor ose me prani fizike duke respektuar masat për mbrojtje nga KOVID-19.
18. Edukatorët mbajnë komunikim të rregullt me kujdestarët e klasës për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të nxënësve, si dhe për suksesin dhe sjelljen e përgjithshme në shkollë me telefon, komunikimin me video përmes viberit, emailit dhe aplikacionet e tjera të ngjashme, prania e Këshillit të mësimdhënësve përmes ZOOM ose me prani fizike duke respektuar masat e mbrojtjes kundër KOVID-19.
19. Të vendoset njoftim dhe dezinfektues para derës së tualeteve për dezinfektim të detyrueshëm të duarve para dhe pas përdorimit.
20. Të sigurohet lëvizje pa pritje në koridore dhe distanca e nevojshme fizike duke vendosur shenja, në mënyrë që të zvogëlohet rreziku i numrit të madhë të njerëzve në tualete në të njëjtën kohë.
21. Tualetet duhet të jenë të pajisura me sapun të lëngshëm, ujë të nxehtë, shportë për mbeturina me kapak me pedale të këmbës dhe peshqirë letre për një përdorim , si dhe dispanzer me dezinfektues të duarve të bazuar në alkool 70% ose dezinfektues kundër virusit të rekomanduar për dezinfektim.
22. Pastrimi dhe dezinfektimi i tualeteve, dyshemeve dhe të gjitha sipërfaqeve të tyre, 2 herë në ditë, duke përdorur dezinfektusin që vepron kundër virusit sipas udhëzimeve të prodhuesit, në mënyrë alternative 0.05% hipoklorit natriumi (zbardhues 5%) që mund të përdoret për

punët e shtëpisë duke e përzier në raport 1: 100) ose 70% alkool për dezinfektimin e sipërfaqeve të sipërme.

23. Në tualetet dhe hapsirat e zakonshme të vendosni shporta me pedale këmbësh që vendosen brenda me qese plastike, për mbledhjen e mbeturinave nga maskat dhe dorezat e përdorura, të shënuara të shënuar dukshëm dhe të vendosur në disa vende brenda.

24. Punonjësit në mensë dhe kuzhinë, duhet të mbajnë maska mbrojtëse, doreza dhe veshje mbrojtëse dhe të mbajnë higjienë të shpeshtë të duarve.

25. Të shmangni grupimin gjatë pushimeve dhe mbajtjen e distancës reciproke gjatë procesit të punës.

26. Distanca e detyrueshme e sigurt midis tavolinave dhe mbajtja e distancës së sigurt gjatë ngrënies. Dezinfektimi i tryezave dhe karrigave pas vakteve të ngrënjes (mëngjes, drekë, darkë)

27. Tavolinat duhet të mbulohen me mbules prej letrës ose najloni për një përdorim .

28. Vendosni nga një dezinfektues në secilën tryezë.

29. Kompletet për ushqyerje duhet të ruhen dhe shërbehen në mbështjellës najloni ose letre ose peçete. Kompletet e përdorura, përveç larjes me ujë të nxehtë, duhet të dezinfektohen me dezinfektues.

30. Në fund të çdo racioni (mëngjes, drekë, darkë) pastrimi dhe dezinfektimi është i detyrueshëm i të gjitha hapsirave , të gjitha kompleteve për ushqim , sendeve për përgatitjen dhe servirjen e ushqimit, si dhe mensën me të gjitha tavolinat dhe karriget.

31. Në vendin ku shpërndahet ushqimi, vendosni shenja në dysheme që tregojnë drejtimin e lëvizjes dhe të vëzhgoni distancën minimale të obliguar , gjatë pritjes në radhë të nxënësve gjatë shpërndarjes së ushqimit.

32. Dërgesat për nevojat e konviktit merren përsipër nga stafi kompetent të punësuar në konvikte , nga hyrja anësore e shtëpisë, kurse hyrja kryesore lejohet vetëm për teknikët e shërbimit dhe shërbimet e tjera, shërbimet e të cilëve janë të nevojshme (p.sh. Zbatimi i masave parandaluese dhe anti - epidemike si testimi i ujit për konsumim , siguria e ushqimit, etj.) me respektimin e detyrueshëm të masës për dezinfektimin e duarve dhe mbajtjen e maskës mbrojtëse dhe, nëse është e nevojshme edhe mbrojtëset e këpucëve.

33. Kontrolli i brendshëm i përforcuar nga personi përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve për parandalimin e përhapjes së virusit.

34. Nëse një person i infektuar me KOVID-19 shfaqet në konvikt ose një person që ka pasur kontakt me një person të infektuar me KOVID-19, personi duhet të izolohet në dhomë të veçantë me mbajtjen e detyrueshme të maskës mbrojtëse. Nëse është nxënës njoftohen menjëherë prindërit / kujdestarët të cilët në periudhën më të shkurtër kohore duhet ta marrin nxënësin në mënyrë që të konsultohet dhe të vazhdojë aktivitetet me mjekun e amë. Drejtori duhet të komunikojë me Qendrën për Shëndetin Publik për udhëzime mbi veprimet e mëtejshme.

35. Hapsirat ku ka lëvizur personi i infektuar (punonjësi ose nxënësi) duhet të pastrohen, të dezinfektohen dhe ajrosen tërësishtë.